

VENDIM
Nr. 485, datë 11.6.2013

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR FINANCIMIN E FUSHATËS ZGJEDHORE TË SUBJEKTEVE PËRKATËSE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, MË 23 QERSHOR 2013

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, t’i shtohet fondi prej 65 000 000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekësh, për financimin e fushatës zgjedhore të subjekteve përkatëse për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, më 23 qershor 2013.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit për vitin 2013.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha